



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 160, Datë 02.07.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A., PËR
MIRATIMIN E KODIT TË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të neneve 16, 56, pika 1, gërma “g” dhe 63, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; si dhe neneve 19 dhe 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 02.07.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr.100/1 prot., datë 29.06.2021 e përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e Kodit të Transmetimit”,

Konstatoi se:

- Në përputhje me përcaktimet e neneve 56, pika 1, gërma “g” dhe nenit 63, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) ka për detyrë të hartojë dhe publikojë Kodin e Transmetimit në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të ENTSO-e.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) nëpërmjet shkresës nr. 3410 prot., datë 26.05.2021, protokolluar në ERE nr. 703 prot., datë 27.05.2021 ka përcjellë pranë ERE për miratim versionin e ri të “Kodit të Transmetimit”.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 703/1 prot., datë 10.06.2021, drejtuar shoqërisë OST sh.a., ka kërkuar nga kjo e fundit të paraqesë në mënyrë më të detajuar se cilat janë arsyet që çojnë në kërkesën për miratimin e një Kodi të ri të Transmetimit, si dhe të paraqesë argumentet përkatëse lidhur me ndryshimet e këtij drafti me Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 186, datë 10.11.2017, ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 04.06.2018. Në të njëjtën kohë OST sh.a. duhet të bëjë me dije dhe nëse drafti i ri i Kodit, i përcjellë në ERE është konsultuar me palët e interesit.
- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3410/2 prot., datë 15.06.2021, ka parashtruar në ERE informacion shtesë për sa kërkuar, duke bërë me dije se: “Drafti i propozuar synon avancimin e procesit të implementimit të kodeve të lidhjes të ENTSO- E të cilat janë

transpozuar me vendimet e ERE nr. 127, 128, 129, dt. 04/06/2018. Veçanërisht këto ndryshime janë të rëndësishme në kuadër të adresimit të rekomandimeve të Komunitetit të Energjisë të evidentuara në Raportin Vjetor të Statusit të Implementimit të publikuara në nëntor 2020 në lidhje me implementimin e të ashtuquajturve Kode të Lidhjes të ENTSO-E”. Në këtë shkresë shoqëria OST sh.a., ka bërë gjithashtu me dije se: “... me shkresën nr. 4758 prot., dt. 08/09/2020, nga ana e ISHTI është paraqitur kërkesa për pasqyrimin e VKM nr. 482 dhe 483, dt.17/06/2020, në Kodin e Transmetimit. Në përputhje me këtë kërkesë, OST sh.a., ka reflektuar në tërësinë e draftit dhe në veçanti në Pjesën IV - Kërkesa sipas rregullit teknik për linjat dhe instalimet mbi 1 kV të Kodit të Lidhjes me Sistemin e Transmetimit, në draftin e ri, sipas rekomandimeve të ISHTI.”

- Versioni i ri i Kodit të Transmetimit, përcjellë në ERE përmes shkresës nr. 3410 prot., datë 26.05.2021 nga ana e OST sh.a., bazohet në Rregulloren e Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të 2 Gushtit 2017, për përcaktimin e “Udhëzuesit për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, në dallim nga Kodi ekzistues i Transmetimit, i cili është draftuar përpara kësaj Rregulloreje.
- Në analogji me kuadrin e aplikueshëm nga ENTSO-E, në draftin e ri të Kodit të Transmetimit është përfshirë tërësisht Kodi i Emergjencës dhe Restaurimit i cili bazohet në Rregulloren e Komisionit të BE 2017/2196, të 24 Nëntorit 2017, për përcaktimin e “Kodit të Rrjetit të Emergjencave të Energjisë Elektrike dhe Rivendosjes”.
- Në kuadër të detyrimeve për konsultimin paraprak të draftit të Kodit të Transmetimit, OST sh.a., me shkresën nr.1584 prot., datë 05.03.2021, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.), Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.), UPT dhe Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme. OST sh.a., publikoi në website-in e tij draftin e ri të Kodit të Transmetimit për konsultim në periudhën 05.03.2021-03.04.2021. Kërkesa për konsultim, sipërcituar, është përsëritur edhe një herë për palët e interesit nëpërmjet shkresës nr. 1584/3 prot., datë 28.04.2021.
- Në përgjigje të shkresave të mësipërme, OST sh.a., shprehet se MIE dhe DPM kanë shprehur dakordësinë për variantin e ri të Kodit pa dhënë komente apo sugjerime për ndryshime, ndërkohë që UPT përcolli komente të cilat siç OST sh.a., bën me dije, në përgjithësi u reflektuan në draftin i cili është përcjellë në ERE për miratim.
- Në draftin e Kodit të Transmetimit përcjellë nga OST sh.a., rezulton se:

— Ka ndryshime në Kapitullin e Dispozitave të Përgjithshme i cili siguron sa është e mundur që kodet e veçanta pjesë përbërëse të Kodit të Transmetimit, të funksionojnë së bashku dhe të jenë të zbatueshme në praktikë.

— Kapitulli mbi Planifikimin e Sistemit të Transmetimit nuk ka pësuar shumë ndryshime krahasuar me Kodin aktual, por në versionin e ri të Kodit janë bërë ndryshime që reflektojnë praktikën e deritanishme, si dhe është plotësuar me disa elemente të punës praktike me ENTSO-E.

— Gjithashtu, është rishikuar procedura përkatëse për aplikimin për lidhjen me sistemin me qëllim qartësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe të etapave dhe afateve nga aplikimi për lidhje deri në energjizimin dhe fillimin e operimit të përdoruesve. Janë reflektuar dhe përfshirë si dispozita të reja edhe detyrimet sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.482, datë 17.6.2020, «Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”» dhe nr.483, datë 17.06.2020, «Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”».

— Është rishikuar kapitulli në lidhje me Operimin e Sistemit bazuar në Rregulloren e Komisionit të BE 2017/1485, të 2 Gushtit 2017. Ky kapitull vendos rregulla të harmonizuara për OST sh.a., dhe përdoruesit për të garantuar sigurinë e sistemit, disponueshmërinë, shkëmbimin e të dhënave, integritetin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përdorimin e efikas të rrjetit, si dhe rritjen e konkurrencës dhe të përfitimit të konsumatorëve.

— Drafti i ri i Kodit të Transmetimit i propozuar nga OST sh.a., ka rregulla të veçanta të cilat adresojnë çështjet që lidhen me Kushtet e Emergjencave dhe Rivendosjes së Sistemit, të cilat bazohen në Rregulloren e Komisionit të BE 2017/2196, të 24 Nëntorit 2017. Dispozitat e kësaj pjese të Kodit përcaktojnë procedurat dhe veprimet që duhet të kryhen specifikisht në gjendjen e emergjencës, black-out dhe rivendosjes, të cilat janë hartuar si një grup i përbashkët i parimeve dhe kërkesave teknike minimale duke pasur në konsideratë marrjen e masave parandaluese apo përmirësuese në kushtet e operimit sinkron me rrjetin evropian.

— Në draftin e ri të Kodit të Transmetimit janë rishikuar edhe rregullat që lidhen me Operimin e Tregut dhe Rregullat e Matjes me një fokus të veçantë në këto të fundit. Kjo pjesë e Kodit adreson funksionimin e Operatorit të Tregut, operimin e tregut, si dhe marrëdhëniet midis OT dhe OST sh.a., OSSH sh.a., dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.

— Si dhe përcaktuar në nenin 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, ERE publikon për 2 ditë pune një njoftim në 2 gazeta me qarkullim kombëtar dhe në faqen e saj të internetit duke ftuar palët e interesuara ose persona të tjerë të njihen me draftin e ri të Kodit të Transmetimit dhe të dërgojnë komente me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e Kodit të Transmetimit.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI